

VENDIM
Nr.1587, datë 3.12.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.1180, DATË 5.8.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E VLERËS SË TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR
LEGALIZIM DHE MBLEDHJEN E ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TË
PROCESIT TË LEGALIZIMIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.1180, datë 5.8.2008 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 1.4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1.4 Brenda një muaji nga pajisja me formularin e pagesës së tarifës së shërbimit, modeli i të cilit i bashkëlidhet këtij vendimi, subjektet, që do të vazhdojnë procedurat e legalizimit të objekteve pa leje apo shtesave informale, në ndërtime me leje, do ta derdhin këtë pagesë në numrin e llogarisë bankare, të hapur për këtë qëllim nga ALUIZNI.”.

2. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Subjektet, që kanë vetëdeklaruar jashtë afateve ligjore (në muajin e 3-të dhe të 4-t) të periudhës së vetëdeklarimit, së bashku me tarifën e shërbimit do t’i shlyejnë edhe sanksionet e parashikuara për këtë qëllim, për llogari të ALUIZNI-t, duke iu referuar kohës së vetëdeklarimit dhe natyrës së ndërtimit informal (vilë, shtesë familjare, shtesë tregtare), të parashikuara në nenin 8 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar. Të ardhurat e mbledhura nga këto sanksione së bashku me tarifën e shërbimit, do të përdoren nga ALUIZNI, në përputhje me përcaktimin e bërë në pikën 1.2 të këtij vendimi.”.

3. Pika 3.3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3.3 Taksa e ndikimit në infrastrukturë paguhet brenda 30 ditëve nga data e pajisjes me formularin e pagesës, modeli i të cilit i bashkëlidhet këtij vendimi, për llogari të njësisë së qeverisjes vendore, ku ndodhet ndërtimi informal. Fondi i krijuar nga pagesa e kësaj takse, do të përdoret për financimin e studimeve urbanistike, realizimin e tyre dhe përmirësimin e infrastrukturës së territoreve, që legalizohen.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha